

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: “RIKONSTRUKSION I RRUGES SE VARREZAVE MELGUSH”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45000000-7, punë ndërtimi

VLERA E FONDIT LIMIT: **10.000.873** (dhjete milion e teteqind e shtatedhjete e tre) lek pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Vau Dejës** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të Nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. *Bashke me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik*”.

Neni 83 i LPP “*Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël*”,

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe si dhe në Ligjin Nr.9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022-2023-2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera së përlogaritur të kontratës që prokurohet.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, *”Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën”, ”Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.”*, si dhe bazuar në nenin 43, pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: *b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar*

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe vendosja e këtij limiti nuk kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.” pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës bilancin kontabël së bashku me anekset e tij, si dhe Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022 -2023dhe 2024, të certifikuara nga autoritetet përkatese (Dega e Tatim Taksave) ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet për vitin 2025 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2025.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenin 43, nenin 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Për QKR” i ndryshuar.

Meqenese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: **5.000.436** (pese milion e katerqind e tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: **20.001.746** (njetzet milion e shtatëqind e dyzet e gjashtë) lekë pa TVSH.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve të siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;**(nese leshohet)**
 - Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;**(nese leshohet)**
 - Çertifikatën e marrjes në dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim;
 - Fatura tatimore perkatese.

Argumentimi: Përvoja e suksesshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: **5.000.436** (pese milion e katerqind e tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

b.Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: **20.001.746** (njetzet milion e shtatëqind e dyzet e gjashtë) lekë pa TVSH.

Pika 1/a plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Gjithashtu referuar VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Kreu XI, Neni 88, pika 3 citohet se: “Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtarë, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në

raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (1.2-1.4), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: *”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: *”Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.*

AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave 1.3 dhe 1.4, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Sqarojmë se nga praktika, gjatë fazes së vlerësimit të ofertave, AK ka hasur vështirësi në vlerësimin në mënyrë sa më të drejtë të përvojës së ngjashme, pasi jo të gjitha institucionet shtetërore apo private leshojnë Formularin e Vlerësimit sipas formatit zyrtar (ku përcaktohet ndarja e përqindjeve). Në kuadër të vlerësimit të ofertave në mënyrë sa më të drejtë, duhet që në rastet e BOE apo Nenkontraktim, vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontrates së bashkëpunimit; me marrëveshjen e nenkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nenkontraktimit leshuar nga Institucioni. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qene Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk mund të sjellë kufizim të pjesëmarrjes së OE në tender as në mënyrë direkte dhe as në mënyrë indirekte.

Gjykojmë që kërkesa e mësipërme nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore që parashikon legjislacioni i prokurimit publik.

Gjithashtu vendosim në kushte të barabarta dhe u jep mundësi të gjithë OE ofertues edhe në ato rastet kur Formularët e Vlerësimit mund të jenë të paplotesuara sipas standartit.

AK ka kërkuar keto dokumenta në përputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku ndër të tjera përcaktohet se: *”Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”*

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licencë profesionale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e cila të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Punime të përgjithshme ndërtimi:

Kategoria NP-1 Niveli A “Punime germimi”

Kategoria NP-4 Niveli A “Rruge ,autostrada,mbikalime”

Kategoria NP-5 Niveli A “Punime Nentokesore , ura e vepra arti”

Punime speciale ndërtimi:

Kategoria NS-6 Niveli A “Punime për sinjalistiken”

Kategoria NS-18 Niveli A “Punime topogjeodezike”

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar.

Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në pdrputhje me standartet kombëtare ose europiane. Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomik të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko profesionale ne nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Licencat janë të lidhura ngushtësisht me zerat e punimeve te ndërtimit. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti i vlerëson të nevojshme, për sa kohë ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
<u>Kategoria NP-1</u>	Punime germimi	Kapitulli 1 i preventivit	Niveli A	261,285.04
<u>Kategoria NP-4</u>	Rruge ,autostrada,mbikalime	Kapitulli 2, 3 dhe 4 i preventivit	Niveli A	8,548,373.81
<u>Kategoria NP-5</u>	“Punime Nentokesore , ura e vepra arti”	Kapitulli 5 i preventivit	Niveli A	512,511.78
<u>Kategoria NS-6</u>	Punime per sinjalistiken	Kapitulli 6, 7 dhe 8 i preventivit	Niveli A	202,470.12
<u>Kategoria NS-18</u>	Punime topogjeodezike		Niveli A	

Shenim: Pika e licences për punime topogjeodezike është kërkuar për shkak se kemi të bëjmë me infrastrukturë rrugore dhe projekti parashikon përmirësim të gjeometrisë horizontale dhe vertikale të rrugës. Piketimi dhe kontrolli topografik duhet bërë në cdo fazë të zbatimit të punimeve.

2.3.3 Vetdeklarimin nga inxhinierat se ata jane te disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar ne Rekomandimin Nr. 6732 date 21.10.2020 “Mbi Problematikat e konstatuara gjate monitorimit nga APP”.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për realizimin dhe zbatimin e kontratës. Për kryerjen e punimeve numri i punonjësve perfshire dhe stafin inxhinierik duhet të jetë minimalisht 11 (njembedhjetë) punonjës te cilet duhet të figurojne në listëpagesat e të paktën muajt te fundit, sipas kërkesave specifike per cdo punonjes si më poshtë :

2.3.4.a) Stafi inxhinierik
a) 1 (një) inxhinier ndërtimi - drejtues teknik

Inxhinieri i ndërtimit duhet te jete i pajisur me diplome dhe duhet të figurojë si drejtues teknik në licencën e shoqërise si dhe te disponojë kontrate pune te vlefshme.

b) 1 (nje) inxhinier ndërtimi

Inxhinieri i ndërtimit duhet te jete i pajisur me, kontrate pune te vlefshme dhe diplome.

Inxhinieri i ndërtimit duhet të paraqesë një deklaratë ku garanton se nuk do të jetë i angazhuar në kontrata të tjera gjatë gjithë afatit të zbatimit të kontratës që prokurohet.

- ***Në rast se inxhinieri i kërkuar në pikën 2.3.4 germa a, nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe është i disponueshëm në kantier gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës, gjë të cilën ai do ta vërtetojë me paraqitjen e deklaratës, atëherë pika 2.3.4 germa b nuk është e detyrueshme të plotësohet.***

c) 1 (nje) inxhinier topograf

Inxhinieri topograf duhet te jete i pajisur me licence profesionale dhe kontrate pune te vlefshme.

Inxhinieri topograf duhet të paraqesë një deklaratë ku garanton se është i disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate.

2.3.4.b) Stafi i punetoreve te specializuar

a) 3 (tre) Manovratorë

Manovratorët (drejtuesit e makinerive të rënda eksavatorit/ fadromës, makinave ngjësëse dhe të asfaltimit) duhet të jenë punonjës te specializuar për drejtimin e mjeteve të rënda dhe për këtë duhet të paraqesin deshmi nga Drejtoria e Sherbimit te Transportit Rrugor, deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente. (Në rastin kur punonjësit Manovrator janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

b) 2 (dy) shoferë kamioni

Shoferët e kamionit duhet të jenë punonjës te specializuar për drejtimin e mjeteve të rënda dhe për këtë duhet të paraqesin deshmi nga Drejtoria e Sherbimit te Transportit Rrugor, deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente. (Në rastin kur këto punonjës janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

c) 2 (dy) Betonues dhe te tjere qe lidhen me to

d) 2 (dy) punetore asfalti

Nga ana teknike argumentojmë se numri mesatar i punonjësve është caktuar në bazë të llogaritjeve të zërave të punës dhe volumit përkatës të cdo zëri në preventiv si dhe grafikut në zbatimit të punimeve, të cilat duhet të përfundojnë brenda 2 muajve kalendarikë nga data e nënshkrimit të kontratës, mbështetur kjo në VKM Nr. 216 datë 13.04.2023 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

- Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese vertetim të lëshuar nga Dega e Tatim Taksave ose Dega e Sigurimeve Shoqerore dhe Shëndetsore në të cilin të jetë i percaktuar numri i punonjesve të siguruar për periudhen e mësipërme, shoqëruar me listepagesen perkatese E-Sig, për kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shëndetsore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” ne nenin 39, pika 6, germa c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar

Eshtë kërkuar inxhinier ndertimi për zbatimin e punimeve ne perputhje me zerat e punimeve te preventivit, projektit, specifikimeve teknike qe do te zbatohen dhe si dhe kategorive perkatese ne licencen perkatese te zbatimit. Inxhinieri ndertimit është përgjegjës për zbatimin e saktë të projektit për secilin nga zërat e punimeve. Ai është përgjegjës për cilësinë e materialeve qe vendosen ne objekt . Janë kërkuar inxh. Ndërtimi drejtues teknik dhe inxhinier ndërtimi, në mënyrë që të mos penalizohen OE që drejtuesit teknikë i kanë të angazhuara në kontrata të tjera. Inxhinieri i ndërtimit është kërkuar që të jetë inxhinier i kantierit, nën mbikqyrjen dhe udhëzimet e drejtuesit teknik.

Është kerkuar inxhinier topograf per kryerjen e punimeve topografike per nxjerrjen e kuotave te punimeve te germimit si dhe kuotat e shtresave rrugore, sistemimin e kanaleve anësore etj.

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe 39, pika 6, gërma Ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e ketyre kriterëve për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve që është përlogaritur si dhe mjeteve të kërkuara për zbatimin me sukses të kësaj kontrate.

Kërkesa që punonjësit të jenë me deshmë kualifikimi të sigurimit teknik (te vlefshme) të leshuara nga organizma të akredituar për këtë qëllim në Republikën e Shqipërisë është bërë bazuar duke vlerësuar se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin deshmë për sigurimin e jetës dhe shëndetit të punëmarrësve nëpërmjet zbatimit të masave të nevojshme.

Kërkesa për deshmitë e drejtuesve të mjeteve të rënda bazohet në Urdhërin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 200, datë 16.5.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit” Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe 39, pika 6, gërma Ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në lidhje me vërtetimin të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve kjo kërkesë është e mbështetur në Nenin 39, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” sipas së cilës: ”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriterë të tjerë të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Kategorizimi i profesionit të punonjësve është bërë bazuar në kodet e përcaktuara në VKM 514 datë 15.09.2017, si më poshtë:

7114 Betonues dhe të tjerë që lidhen me to : Kodi i profesionit: 7114 Përshkrim i përgjithshëm i grupit të profesioneve “Betonues dhe të tjerë që lidhen me to”, niveli i dytë i kompetencës në LKP. Betonuesi dhe të tjerë që lidhet me to ndërton korniza dhe struktura të përforcuara prej betoni ose prej allçie, përforcojnë sipërfaqet e çimentos, bën vendosjen e çimentos në mure, korniza shkallësh, tarraca, etj. Gjithashtu, ai përfundon dhe riparon sipërfaqe prej çimentoje. Ndërton struktura të përforcuara hekuri për vëllimet apo sipërfaqet që do të betonohen sipas një projekti paraprak. Ai mund të punësohet në kompani të ndryshme me aktivitet ndërtimi apo të vetëpunësohet. Funksionet kryesore: Betonuesit dhe të tjerë që lidhet me to kryejnë një pjesë ose tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës: “a) Njihen me projektin dhe specifikimet teknike të objektit ku do të punojnë; b) Bëjnë kontrollin paraprak të vendit të punës para fillimit të procesit; c) Bëjnë organizimin e punës me kolegët e tjerë përpara fillimit të procesit; d) Bëjnë sistemimin e materialeve dhe veglave të punës sipas proceseve të punës. e) Respektojnë me rigorozitet radhën e kryerjes së çdo procesi pune sipas orientimit të dhënë në objekt; f) Sigurojnë sasinë e duhura të materialeve për betonin (hekur, dërrasa, skela, zhavorr, çimento, rërë, ujë etj.), sipas markave të përcaktuara në projekt; g) Realizojnë – në bashkëpunim me punëtorët e tjerë – ndërtimin e skelës që do shërbejë si plan pune për zhvillimin e operacionit; h) Ndihmon në ndërtimin e armaturës brenda së cilës do derdhet betoni, vendosjen e kallëpeve apo formave të ndryshme sipas projekteve paraprake; i) Vendosin shtyllat mbajtëse të peshës, morsetat dhe mjetet e tjera që sigurojnë qëndrueshmërinë e armaturës ndaj peshës dhe presionit të ngarkesës beton; j) Ndihmojnë në vendosjen e hekurit të duhur dhe lidhjen e tij; në sasinë dhe formën e përcaktuar në projektin inxhinierik; k) Realizojnë procesin e përzierjes së sasisë së duhur dhe raportet e paracaktuara të materialeve përbërëse të betonit me sasinë e duhur të ujit, me dorë ose me makineri; l) Shpërndajnë betonin dhe e shtrojnë atë në soleta, kolona, shkallë, mure, ballkone, ura, apo strukturave të tjera në kohën e duhur, sipas radhës së përcaktuar nga projekti dhe drejtuesi teknik i objektit; m) Bëjnë vibrimin e betonit gjatë çdo betonimi; n) Kryejnë nivelimin e betonit;7 o) Kryejnë lustrimin e betonit apo çimentos; p) Bëjnë trajtimin me ujë të strukturave pas betonimit; q) Bëjnë riparimin e defekteve të vogla pas betonimeve (zgavra, vrima etj.); r) Bëjnë dorëzimin e punimeve tek drejtuesi teknik i objektit duke bërë dhe shënimet përkatëse të afateve të punimit të kryer; s) Bëjnë riparime të ndryshme të sipërfaqeve të betonuara; t) Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit. u) Bëjnë preventiv për shërbimet e ndryshme që realizohen në njësinë e biznesit”

7119.15 Punëtor asfaltimi në rrugë (Grup njësi - Punëtorë ndërtimi të paklasifikuar diku tjetër) y) Kryejnë asfaltime apo punime mirëmbajtje në rrugë;

Kërkesat për punësim: a. Zakonisht kërkohet përfundimi i një kualifikimi profesional për këtë profesion. b. Të jetë e/i aftë fizikisht dhe mendërisht.

Manovratorët (drejtuesit e makinerive të rënda eksavatorit/ fadromës, makinave ngjësëse dhe të asfaltimit) dhe shoferat e kamionit (Grupi-njësi (Profesioni) “Shoferë të makinave të rënda dhe kamionëve” Kodi i profesionit: 8332)

8332.03 Drejtues të makinave të asfaltimit

8332.06 Drejtues të makinave të ngjeshjes (rrula)

8332.14 Shofer kamioni

Kërkesat për punësim a. Të jetë e/i pajisur me leje drejtimi të nivelit përkatës. b. Zakonisht kërkohet përfundimi i një shkolle profesionale në këtë fushë. c. Të ketë kryer një kurs formimi profesional për këtë profesion. d. Të jetë e/i aftë fizikisht dhe mendërisht.

8343 Vinçierë (Grup njësi ‘‘Vinçierë dhe operatorët lidhur me to ‘’ Kodi I profesionit 8343)

Funksionet kryesore : Vinçierët dhe operatorët e lidhur me to kryejnë një pjesë ose tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës:a) Kryejnë kontrollin e përgjithshëm të mjetit, para fillimit të punës;b) Sigurohen se janë vendosur shenjat dalluese në vendin ku do të punohet (rrethohet me shirit dallues);c) Kryejnë inspektimin para fillimit të punës për të llogaritur kapacitetet ngritëse të vinçit dhe peshën për t'u përgatitur për manipulim;

d) Kujdesen për transport të sigurt të mallrave duke i siguruar, lidhur ato gjatë ngarkimit,

shkarkimit, rrëshqitjes apo lëvizjeve të ndryshme;e) Inspektojnë pajisjet, për të identifikuar prishjet dhe dëmtimet që mund të jenë bërë;f) Pozicionojnë ose heqin pajisje të nevojshme nën, mbi, rreth paletës, ngarkesës, kutisë dhe materialeve të tjera për të siguruar transportin e tyre në zonat e përcaktuara;g) Vlerësojnë peshën në përputhje me kufizimet e ngarkesës duke siguruar shpërndarjen e duhur të peshave dhe ekuilibrin e tyre gjatë lëvizjes;h) Përdorin dhe monitorojnë pajisje ngritëse për të transportuar apo mbajtur njerëz në një lartësi të caktuar gjatë kryerjes së punës së tyre; (p.sh në linjat e ndriçimit të rrugëve, në miniera etj.) i) Mbajnë shënime për punën e ndërmarrë dhe avaritë e ndodhura gjatë punës me automjetet e veta; j) Zbatojnë rregullat teknike gjatë përdorimit të vinçave si p.sh diagramin e vinçit (kombinimi i ngarkesës në funksion të rrezes);

k) Bëjnë llogaritjet dhe plotësimin e faturës përkatëse për punën e kryer;l) Kryejnë punime të mirëmbajtjes periodike, të tilla si pastrim dhe lubrifikim të vinçit; m) Pastrojnë dhe mirëmbajnë mjetin e punës dhe e lënë atë në gjendje të gatshme për punë; n) Realizojnë detyra të ngjashme;

o) Mbikëqyrin punëtorët e tjerë;p) Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit. **Kerkesat per punesim** : a. Të jetë e/i pajisur me leje drejtimi/manovrimi të posaçme për këtë profesion. b. Të ketë kryer një kurs formimi profesional për këtë profesion.

c. Të jetë e/i aftë fizikisht dhe mendërisht.

Numri i manovratorëve dhe shoferëve të kamionit është përcaktuar nga numri i makinerive që janë të domosdoshme për kryerjen e punimeve, 7 makineri dhe 2 kamionë, si dhe mbështetur në bashkërendimin dhe mbivendosjen e proceseve të punës sipas grafikut të zbatimit të punimeve.

2.4 Ofertuesi duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme për kryerjen e punimeve, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit :

Nr	Mjetet	Sasia	
1	Mjet transporti veteshkarkues ≥ 10 ton (kapac. mbajtes)	1 cope	Në pronësi ose me qera
2	Autovinc deri 5 ton	1 cope	Në pronësi ose me qera
3	Mjet transporti veteshkarkues min 3.5 ton (kapac. mbajtes)	1 copë	Në pronësi ose me qera
4	Eskavator	1 copë	Në pronësi ose me qera
5	Betoniere 500 l	1 copë	Në pronësi ose me qera
6	Vibrator thellesie	1 copë	Në pronësi ose me qera
7	Grejder	1 cope	Në pronësi ose me qera
8	Autobot uji	1 cope	Në pronësi ose me qera
9	Rrul me vibrim per ngjeshje çakelli	1 cope	Në pronësi ose me qera
10	Rrul kompresor per ngjeshje asfalti	1 cope	Në pronësi ose me qera
11	Autobitumatrice	1 cope	Në pronësi ose me qera
12	Asfaltoshtruese	1 cope	Në pronësi ose me qera
13	Makineri vijëzimi	1 copë	Në pronësi ose me qera

Si deshmi per plotesimin e kesaj pike Operatori duhet te paraqese:

- i. Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë, të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe certifikatën për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme).
- ii. Për mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre: aktet e zhdoganimit ne Republikën e Shqiperisë ose faturat tatimore te blerjes.
- iii. Për te gjitha mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i kontratës.

- iv. Per mjetet e marra me qera qe shenohen ne regjistra publik, duhet te paraqitet dokumenti qe vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikata për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Kurse per mjetet qe nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti qe vërteton pronësinë e tyre, aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.
- v. Operatori/et ekonomik ofertues duhet te deklaroje qe te gjitha mjetet dhe pajisjet e pershkruara, do te jene te angazhuara vetem ne kete kontrate. Mjetet te cilat rezultojne te angazhuara ne kontrata te tjera afati i zbatimit te cilave shtrihet pergjate afatit te kontrates objekt i prokurimit jane shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor gezon te drejten te verifikojë dhe kontrollojë disponueshmerine e ketyre mjeteve si gjate vleresimit te ofertave ashtu edhe gjate zbatimit te kontrates.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, të paraqitura më sipër.

2.5 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin çertifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) per objektin qe prokurohet, si me poshte

- a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave te punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit).

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 10 gërma “a”- “c” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Përmiratimin e rregullavetëprokurimit publik”i ndryshuar, kupërcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, qe i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

2.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit për 60 dite kalendarike.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 3.

2.7 Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me liçencat profesionale të mëposhtme:

- Licencë nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve”.
- Operatori ekonomik duhet të ketë një kontratë me një landfill të vlefshme, Vendi i depozitimit duhet të jete brenda territorit administrativ të qarkut Shkoder.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Kjo kërkesë mbështetet në faktin që sipas punimeve të parashikuara në preventiv do të kemi punime gërmimi.

2.8. Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/certifikuar te cilet duhet te figurojnë në listëpagesën e shoqërisë për tre muajt e fundit, Për secilin duhet të paraqiten: Kontratë individuale të punës dhe Diplomë/certifikate:

- 1 (një) punonjes të disponojë certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Argumentimi Kërkesat e mësipërme janë vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesat e mësipërme mbështeten në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë"; V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier"; ligjin Nr. 10431 datë 09.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" dhe ne mbështetje te pikës 4 te nenit 49 te Ligjit Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin". Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga zjari apo çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar. Kjo kërkesë mbështetet në faktin që preventivi i zbatimit të punimeve parashikon gjurmime të dherave, punime shtresash rrugore me çakëll, stabilizant si dhe punime betoni. Nga çdo veprimtari ndërtimore ka mbetje interte të cilat duhen grumbulluar dhe depozituar në vendin e caktuar. Gjithashtu jemi bazuar në Ligjin Nr.10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" (I ndryshuar), si dhe në VKM 99 datë 18.02.2005 "Për Miratimin e Katalogut Shqiptar Të Klasifikimit Të Mbetjeve", shtojca I, ku dherat bëjnë pjesë në kategorinë e mbetjeve me kod 17 05, çakëlli bën pjesë në kategorinë e mbetjeve 17 05 08, ndërsa betoni bën pjesë në kategorinë e mbetjeve 17 01 01.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.”, sjellim ne vemendje se:

- Disponimi i punonjësve dhe i mjeteve/pajisjeve të kërkuara do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit(shtojca8) gjatë fazes së ofertimit.
- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t'i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit për disponimin e punonjësve, mjeteve/pajisjeve do të jetë kusht s'kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të bejë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetë deklarin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s'kualifikimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e

mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.